



Zeqir HODA, Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Zeqir Hoda është Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, si përfaqësues i Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë.

Në vitin 1986 ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike, Dega Filozofi, Universiteti i Tiranës dhe në vitin 1996 ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Gjatë karrierës profesionale 25 vjeçare si prokuror, ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurori të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, ku në disa prej tyre ka ushtruar dhe detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë si me poshtë:

- 1997-1998 Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Has.
- 2002-2008 Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë.
- 2013-2016 Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin. ▪ 2016-2016 Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
- 2017-2018 Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Funksionin si prokuror e ka ushtruar në Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor Kukës, Durrës, Krujë dhe së fundmi Tiranë.

Prej muajit Dhjetor të vitit 2021 ushtron detyrën si Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.